



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinita Org.Unit	02
Nr. i Fajevë Br. Stranica No. Pages	001 -
Nr. i Prot. Ibroj Prot. Prot. No.	1120-2/23
Data: Datum: Date	15.03.23
PRISHTINË / A	
No. 1	

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Për:	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Nr. VL-56/23 Datë: 10.03.2023
1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të
2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.016-14451 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Biraq, miratuar nga KK Suharekë.

Inderuari Kryetar, Muharremaj,
Inderuari Kryesues, Kuqi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL Vendimi Nr.016-14451 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Biraq, miratuar nga KK Suharekë, datë 28.02.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Suharekës, konstaton :

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimi Nr.016-14451 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Biraq, miratuar nga KK Suharekë, datë 28.02.2023.

A r s y e t i m i

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.016-14451 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Biraq, miratuar nga KK Suharekë, konstatoi se:

- **Neni 1** i vendimit duhet të plotësohet me të dhënat e Zonave Kadastrale dhe parcelat kadastrale që përfshihen në këto plane.
- **Neni 1** i Vendimit Nr.016-14451 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për " Zonën Industriale" në Biraq, PRRH në Biraq (të plotësohet emërtimi), sepse si i tillë nuk përputhet me Hartën Zonale të Komunës. Në HZK parashihen PRRH-të për Zonën Industriale në Duhël, andaj, të plotësohet emërtimi.

Vërejtje:

Lidhur me sipërfaqet e parapara për hartimin e këtyre planeve me këto vendime, sipërfaqet janë të përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës në fuqi dhe si të tilla duhet të respektohen.

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

